

NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH. A.
GJ.P "AUTOBUSKA STANICA" A. D.
MPE "BUS STATION" J. S.

Nr. 02/1404 Data 31.07 20 25
No. Date

PRISHTINË/A



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË
GJ.P "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh. A. Prishtinë

Biznes Planit 2025

Prishtinë, Korrik 2025

N.P.L " Stacioni i Autobusëve" SH.A. - Prishtinë

Rr. Bill Clinton, p.n - Prishtinë / Republika e Kosovës

www.sap-rks.com; contact@sap-rks.com

+383 (38) 551 333

PËRMBAJTJA

1	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
2	Historia e ndërmarrjes.....	3
3	Vizioni.....	4
4	Misioni.....	4
5	SWot analiza e ndërmarrjes.....	5
6	Planifikimi i buxhetit financiar për vitin 2025.....	5
	6.1Të hyrat.....	6
	6.2Investimet.....	6
	6.3Amortizimi.....	7
	6.4 Të ardhurat NETO pas Amortizimit.....	7
7	Objektivat për vitin 2025.....	7
	7.1 Rritja e të hyrave përmes optimizimit të burimeve ekzistuese.....	7
	7.2Ngritja e cilësisë së shërbimeve dhe kushteve të punës.....	8
	7.3Zgjerimi i kapaciteteve operacionale dhe rritja e funksionalitetit.....	8
	7.4 Rritja e qëndrueshmërisë financiare.....	9
8	Burimet njerëzore.....	9
	8.1Nevojat aktuale për personel.....	9
	8.2 Politika e kompensimit të stafit dhe matja e performances.....	10
	8.2.1. Kualifikimi shkollor i kërkuar për vendin e punës;.....	10
	8.2.2. Ndërlikueshmëria e punës, në raport me përgjegjësitë dhe sfidat që mbart pozita;.....	10
	8.2.3. Rëndësia e detyrës në kuadër të funksionimit të përgjithshëm të ndërmarrjes;.....	10
	8.2.4. Rrezikshmëria në vendin e punës, si faktor që ndikon në kompensimin shtesë;.....	10
	8.2.5. Kushtet dhe intensiteti i punës, që lidhen me mjedisin dhe ngarkesën e punës;.....	10
	8.2.6. Përvoja profesionale, e cila njihet si përparësi dhe vlerë e shtuar në sistemin e kompensimit.....	10
	8.3 Ngritja e mirëqenës së punëtoreve.....	10
	Anexi 5 struktura organizative (organogrami).....	11
9	Plani operativ mbi zbërthimin e objektivave.....	11
	9.1Objektivat 1 Rritja e të hyrave optimizimit të burimeve ekzistuese.....	11
	9.2Objektivi 2. Ngritja e cilësisë së shërbimeve.....	11
	9.3Objektivi 3. Zgjerimi i kapaciteteve operacionale dhe modernizimi.....	12
10	Anexi 1 tabela e rishikimit të buxhetit 2025.....	13
11	Anexi 5 organogrami.....	16

1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Plani i Rishikuar i Biznesit për vitin 2025

Rishikimi i Planit të Biznesit për vitin 2025 është paraqitur si një domosdoshmëri strategjike, duke reflektuar një vizion të ri për ndërmarrjen, me qëllimin kryesor për të ofruar shërbime më cilësore për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Ky rishikim mbështetet në bazën ligjore të përcaktuar me Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dhe buron nga zhvillimet e fundit organizative dhe financiare brenda ndërmarrjes. Në veçanti, me vendimet e Bordit të Drejtorëve të miratuara gjatë tremujorit të dytë të vitit 2025, janë ndryshuar:

- I. Çmimorja për shërbimin e parkimit të automjeteve (prill 2025);
- II. Çmimorja për shërbimin e peronizimit (qershor 2025, me hyrje në fuqi më 01.07.2025).

Këto ndryshime pritet të ndikojnë dukshëm në rritjen e të hyrave vetanake të ndërmarrjes, duke kontribuar drejtpërdrejt në forcimin e qëndrueshmërisë financiare, dhe rritjen e investimeve kapitale në afro 300% për më shumë krahasuar me planin fillestar të vitit 2025.

Në funksion të transparencës dhe analizës efektive financiare, më poshtë është përgatitur një tabelë krahasuese që pasqyron ndryshimet në buxhet për vitin 2025, sipas kategorive të të hyrave, duke krahasuar planin fillestar me rishikimin aktual.

Ky krahasim shërben si bazë për vlerësimin e ndikimit të masave të ndërmarra dhe për mbështetjen e objektivave të menaxhimit të ndërmarrjes në periudhën afatmesme.

2 Historia e ndërmarrjes

Ndërmarrja Shoqërore (NSH) Stacioni i Autobusëve, në Prishtinë, është themeluar në vitin 1977, nga fondet e Bankës Botërore të cilat u dhanë për shtetet e pazhvilluara. Kosova si njësi e ish shtetit të Jugosllavisë përfitoi nga kjo ndihmë.

Në vitin 1983 pas shpronësimeve që bëri Komuna e Prishtinës u vendos që Stacioni i Autobusëve të vendoset në hapësirat ekzistuese të sotme.

Pas përfundimit të luftës, në vitin 1999, ndërmarrja është administruar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM). Në ndërkohë, në vitin 2015 është transformuar në ndërmarrje publike komunale, si shoqëri aksionare me Kuvendin Komunal (KK) të Prishtinës, si pronar të vetëm të ligjshëm të të gjitha aksioneve të ndërmarrjes. Në këtë kontekst, KK i Prishtinës ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e parapara me ligjet në fuqi, por edhe me Statut dhe akte të tjera nënligjore të Ndërmarrjes.

Ndërmarrja realizon të hyra vetanake dhe nuk varet nga buxheti komunal. Burimet kryesore të hyrave janë shërbimi i peronizimit (pranimi dhe përcjellja e autobusëve), shërbimi i shitjes së biletave për operatorët e transportit, shërbimi i ruajtjes së bagazhit të udhëtarëve, shërbimi i parkingut, shërbimi i poligoneve për auto shkolla, qiradhënia e lokaleve afariste në pronësi të Stacionit.

Vizioni i ndërmarrjes është që në vazhdimësi të ofrojë shërbime sa më cilësore për publikun dhe klientët, por edhe të ketë një qëndrueshmëri financiare, ngase këto dy elemente janë qenësore për zhvillimin dhe modernizimin e mëtutjeshëm të Stacionit të

Autobusëve – që krahas aeroportit të vendit, sigurisht se përfaqëson portën kryesore për hyrje në Kosovë, si për udhëtime brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

Si rrjedhojë, NPL Stacioni i Autobusëve Sh. A. Prishtinë planifikon të mbetet një qendër e rëndësishme e ofrimit të shërbimeve për klientët e vetë të shumtë, qofshin ata vendorë ose ndërkombëtarë.

3 Vizioni

NPL Stacioni i Autobusëve sh.a. – Prishtinë synon të jetë pikë referuese për transportin e udhëtarëve, duke u pozicionuar si një qendër moderne, konkurruese në nivel rajonal dhe atraktive për të gjithë përdoruesit e shërbimeve. Objektivi kryesor është ofrimi i shërbimeve të qasshme, të pranueshme dhe në kushte të mira, gjithmonë në funksion të plotësimit të kërkesave të konsumatorëve dhe maksimizimit të të ardhurave.

Vizioni afatgjatë i ndërmarrjes është që në vazhdimësi të ofrojë shërbime cilësore për publikun dhe klientët, duke ndërtuar një qëndrueshmëri të fortë financiare. Këto dy elemente – cilësia dhe qëndrueshmëria – janë thelbësore për zhvillimin dhe modernizimin e mëtejshëm të Stacionit të Autobusëve, i cili, krahas aeroportit ndërkombëtar, përfaqëson një nga pikat kryesore të hyrje-daljeve në dhe nga Kosova.

Si rezultat, ndërmarrja planifikon të mbetet një qendër e rëndësishme për ofrimin e shërbimeve për një gamë të gjerë klientësh, vendorë dhe ndërkombëtarë. Planifikimi strategjik për modernizim dhe zhvillim është tashmë në proces, ndërsa në të ardhmen e afërt do të fillojë edhe implementimi konkret i projekteve të shumta, të cilat synojnë të zgjerojnë dhe përmirësojnë gamën e shërbimeve – qoftë ato fizike apo digjitale.

Përmes këtyre investimeve dhe risive, Stacioni i Autobusëve pritet të njohë rritje të qëndrueshme të të hyrave, si dhe përmirësim të dukshëm të imazhit të ndërmarrjes, të Kryeqytetit dhe të vendit në tërësi.

4 Misioni

Misioni i NPL Stacioni i Autobusëve sh.a. – Prishtinë është të ofrojë shërbime cilësore, të drejta dhe të qasshme për të gjithë pasagjerët që shfrytëzojnë shërbimet e stacionit, për bizneset që operojnë brenda hapësirave të ndërmarrjes, si dhe për operatorët e ndryshëm të transportit që veprojnë nga apo përmes Stacionit të Autobusëve në Prishtinë.

Përmes ngritjes së vazhdueshme të cilësisë së shërbimeve dhe efikasitetit operacional, ndërmarrja synon të rrisë të hyrat dhe të krijojë një strukturë të qëndrueshme financiare, duke u konsoliduar si një ndërmarrje publike komunale moderne dhe funksionale, në shërbim të qytetarëve dhe zhvillimit të Kryeqytetit.

Përparësitë - Infrastrukturë solide për ofrimin e shërbimeve. - Kushte dhe lokacion i përshtatshëm për operim dhe qasje të lehtë për udhëtarët. - Hapësirë e mjaftueshme për zgjerim të kapaciteteve dhe zhvillim të shërbimeve të reja. - Stacioni i vetëm në Republikën e Kosovës me licencë të kategorisë "A". - Fuqi punëtore e mjaftueshme për mbulimin e nevojave operacionale. - Ofrim i shërbimeve cilësore dhe profesionalizëm në menaxhim.	Dobësitë - Mungesë e pajisjeve dhe teknologjisë moderne të TI-së. - Njohuri të kufizuara dhe mungesë trajnimi profesional në fushën e TI-së për stafin. - Borxhe të trashëguara nga periudhat e kaluara që rëndojnë buxhetin aktual.
Mundësitë - Potencial për rritje të të hyrave përmes zhvillimit të shërbimeve ekzistuese dhe të reja. - Shfrytëzim më efikas i hapësirave të mëdha të parkingut për gjenerim të të hyrave shtesë. - Mundësi për zhvillimin e shitjes dhe rezervimit të biletave online. - Koordinim me institucionet relevante për respektimin e rregullave të nisjes dhe rendit të udhëtimit nga SAP. - Harmonizim i çmimeve të peronizimit në përputhje me licencën e kategorisë "A" dhe standardet e stacioneve rajonale. - Mundësi për shitjen e biletave për të gjitha nisjet nga SAP në një sistem të centralizuar. - Potencial për zhvillim të shërbimeve shtesë dhe bizneseve të tjera mbështetëse në ambientet e SAP. - Mundësi për të rritur motivimin dhe përfshirjen e punonjësve përmes masave stimuluese.	Rreziqet - Borxhet e pashlyera të grumbulluara nga bizneset deri në shkurt të vitit 2023. - Mosha e lartë e një pjese të punonjësve që mund të ndikojë në efikasitetin dhe përshtatshmërinë me teknologjitë e reja. - Operimi i paligjshëm i operatorëve të pa licencuar, që dëmton konkurrencën e ndershme. - Moszbatimi i rregulloreve ligjore nga operatorët transportues për përdorimin e peronëve të SAP. - Rreziku nga dështimi i sistemit të menaxhimit të biletave dhe të dhënave (softuerik). - Rreziku nga sulmet kibernetike që mund të rezultojnë me humbje të të dhënave me rëndësi të lartë për ndërmarrjen.

Planifikimi i buxhetit financiar për vitin 2025

Ndërmarrja Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë (në vijim: SAP) ka hartuar këtë rishikim të planifikimit buxhetor financiar për vitin 2025, duke u bazuar në analizat e performancës, aktivitetet dinamike të realizuara gjatë vitit aktual 2024 si dhe në baze të analizës së impaktit financiar që kanë vendimet e bordit të drejtoreve për ndryshimin e çmimeve të shërbimeve.

Ky planifikim synon vazhdimin e zhvillimit progresiv të ndërmarrjes në përputhje me objektivat të cilat janë shpalosur në vijim të dokumentit si, investimet e planifikuara dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve për qytetarët dhe palët e interesit.

Të dhënat financiare janë të paraqitura në mënyrë të strukturuar përmes tabelave buxhetore që përfshijnë:

Të hyrat e planifikuara, Shpenzimet operative, administrative dhe të personelit, si dhe Investimet kapitale të parashikuara për vitin 2025.

Secila nga vijat buxhetore shoqërohet me përshkrime të detajuara dhe sqarime për llogaritjet e realizuara, duke mundësuar transparencë, qartësi dhe logjikë financiare në procesin e planifikimit.

6.1 Të hyrat

NPL "Stacioni i Autobusëve", sh.a. Prishtinë (në vijim: SAP) është ndërmarrje publike komunale, e themeluar me qëllim të ofrimit të shërbimeve publike në fushën e transportit të udhëtarëve.

SAP gjeneron të hyrat përmes shitjes së shërbimeve të ndryshme që ofron, të cilat janë të listuara në tabelën e mëposhtme s'bashkua me pjesëmarrjen e produkteve në buxhetin total të të hyrave

A.	1- Te hyrat	Plani momental	Rishikimi	Diferenca
#	Përshkrimi	Totali/Euro	Totali/Euro	%
1	Peronizimi	624,832.63 €	769,877.98 €	51.6%
2	Shërbimi nga shitja e biletave	46,520.76 €	46,520.76 €	3.1%
3	Komisioni nga shitja e biletave	12,505.93 €	12,505.93 €	0.8%
4	Parkingu	343,532.55 €	443,914.87 €	29.8%
5	Gardëroba	2,411.44 €	2,411.44 €	0.2%
6	Qiratë nga lokalet	179,663.95 €	209,909.88 €	14.1%
7	Te hyra nga marketingu	3,050.00 €	6,101.70 €	0.4%
Totali i të hyrave		1,212,517.26 €	1,491,242.56 €	100.0%

Tabela nr. 1. Paraqitja e të hyrave të rishikuara dhe pjesëmarrja e shërbimeve në buxhetin total të të hyrave për vitin 2025

Të gjitha këto shërbime ofrohen me qëllim të përmbushjes së kërkesave të udhëtarëve dhe operatorëve të transportit, si dhe për të mbështetur qëndrueshmërinë financiare të ndërmarrjes dhe zhvillimin e saj të mëtejme.

6.2 Investimet

Me këtë rishikim buxhetor, menaxhmenti i ndërmarrjes ka planifikuar të investojë në ngritjen e kapaciteteve shërbyese, me synim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe arritjen e objektivave strategjike të ndërmarrjes. Investimet kapitale të planifikuara përfshijnë projekte të rëndësishme teknologjike, të cilat pritet të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në ngritjen e të hyrave nga marketingu dhe do të ndikojnë në përvojën e qytetarëve dhe efikasitetin operacional të Stacionit të Autobusëve sh.a Prishtinë. Në këtë periudhë investimet perbejne 4.3% të të hyrave totale të buxhetit dhe është tregues se, menaxhmenti është kujdes për qëndrueshmërinë financiare.

Me poshtë e listuar tabela e investimve.

E.	2.4 Investimet	Plani momental	Rishikimi	Diferenca
1	Furnizim me dritat e brendshme led për holla	1,200.00 €	1,200.00 €	0.00 €
2	Furnizim dhe montim me Klima (Inventore)	3,000.00 €	7,100.00 €	4,100.00 €

3	Furnizim me mjete te TI-se (kompjuter , switch ,disk etj)	8,000.00 €	9,500.00 €	1,500.00 €
4	Furnizim me pajisje për vëzhgim (kamera, DVR, HDD)	1,000.00 €	2,000.00 €	1,000.00 €
5	Furnizim me karrige dhe inventar te zyres	3,000.00 €	3,000.00 €	0.00 €
6	Ndërtimi i Info Pullit ne Holl	0.00 €	6,900.00 €	6,900.00 €
7	Ndërtimi i fontanes	0.00 €	5,500.00 €	5,500.00 €
8	Furnizim me dyer te Hollit	0.00 €	11,200.00 €	11,200.00 €
9	Furnizim me LED Ekran 8.00m x 2.20m	0.00 €	18,000.00 €	18,000.00 €
Totali i kostove investive		16,200.00 €	64,400.00 €	48,200.00 €

Tabela nr. 2. Paraqitja paraqitja e investimeve

6.3 Amortizimi

Shpenzimet e amortizimit për vitin 2025 janë 21,318.44 €. Zhvlerësimi i vitit bëhet konform ligjit mbi pasuritë jo qarkulluese . Ndërmarrja benë tri lloje të zhvlerësimit, zhvleftësimi me 0 zero që zhvlerësohet toka, 5% klasi I, që paraqiten ndërtesat dhe 20% Klasi II, që zhvlerësohen pajisjet. Të gjitha asetet e zhvlerësuar kanë jetëgjatësi më të madhe se një vjet.

Menaxhmenti synon që nëpërmjet rivlerësimit të të gjithë pasurisë ta fus edhe ndërtesën si pjese të kategorisë së amortizimit.

6.4 Të ardhurat NETO pas Amortizimit

Tabela me poshtë vërteton se ndërmarrja po lëviz drejt një faze të qëndrueshmërisë financiare të lartë, me kapacitet të shtuar për të gjeneruar të ardhura dhe për të realizuar investime në të mirë të qytetarëve dhe zhvillimit urban.

1. Te hyrat totale (A)	1,212,517.26 €	1,491,242.56 €	278,725.30 €	23.0%
2. Kostoja totale (B+C+D+E)	1,162,951.83 €	1,254,752.23 €	91,800.40 €	7.9%
Te ardhurat Gross (Te hyrat – Kostot)	49,565.43 €	236,490.33 €	186,924.90 €	377.1%
Amortizimi	21,318.44 €	21,318.44 €	0.00 €	0.0%
Te ardhurat NETO pas amortizimit (Te hyrat – Kostot)	28,246.99 €	215,171.89 €	186,924.90 €	661.8%

Tabela nr. 3. Paraqitja paraqitja e te ardhura NETO

7 Objektivat për vitin 2025

Me këtë rishikim të Biznes planit dhe buxhetit është parashtruar një plan ambicioz me objektiva konkrete si ne vijim

7.1 Rritja e të hyrave përmes optimizimit të burimeve ekzistuese

Rritja e të hyrave totale nga 1,212,517.26 € në 1,491,242.56 €, që përfaqëson një rritje prej rreth 23%, dëshmon për orientimin drejt një modeli më efikas të menaxhimit financiar

Kjo është arritur falë:

- Rishikimit të çmimoreve të shërbimeve, me theks të veçantë në tarifat për peronizim dhe parking.
- Rritjes së të hyrave nga qiratë, pas matjes dhe kategorizimit të lokaleve afariste r cila prite te hyn ne fuqi ne muajin Gusht.
- Dyfishimit te të hyrave nga marketingu pas investimeve ne LED ekranin gjigant.

7.2 Ngritja e cilësisë së shërbimeve dhe kushteve të punës

Menaxhmenti i ndërmarrjes, në kuadër të rishikimit të planit dhe ne kuadër te shpenzimeve operacionale për vitin 2025, ka planifikuar investime që kanë për qëllim të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e shërbimeve për qytetarët dhe kushtet e punës për stafin. Ky objektivi do të realizohet përmes një pakete të gjerë investimesh që përfshijnë:

C.	2.2. Kostot operative (mallra dhe shërbime)	Plani momental	Rishikimi	Diferenca
1	Renovimi i fasadës - lyerja e objektit pjesa e jashtme	0.00 €	€12,900.00	€12,900.00
2	Lyerja e hollit pjesa e brendshme	0.00 €	€2,500.00	€2,500.00
3	Furnizim dhe riparim i dritave LED per mbishkrimin e SAP	0.00 €	€2,500.00	€2,500.00
4	Makin për kositjen e murit te gjalle	0.00 €	€250.00	€250.00
5	Trimer me penje per kositjen e barit	0.00 €	€450.00	€450.00
6	Kositëse e vogel per bari	0.00 €	€350.00	€350.00
7	Renovim i Sporteleve	0.00 €	€5,000.00	€5,000.00
8	Lyerjen e peronave	0.00 €	€2,500.00	€2,500.00
9	Lyerje dhe riparim i rrethojës së Ndërmarrjes	0.00 €	€3,200.00	€3,200.00
10	Shërbimi i printimit dhe fotokopjes, kontrata paraprake e shpenzuar	0.00 €	€950.00	€950.00
Totali		0.00 €	€30,600.00	30,600.00

7.3 Zgjerimi i kapaciteteve operacionale dhe rritja e funksionalitetit

Me këtë rishikim te planit investimet kapitale të reja do të jenë në vlerë prej 64,400 €, krahasuar me vetëm 16,200 € në planin momental.

Janë planifikuar projekte madhore si:

E.	2.4 Investimet	Plani momental	Rishikimi	Diferenca
1	Furnizim me dritat e brendshme led për holla	1,200.00 €	1,200.00 €	0.00 €
3	Furnizim dhe montim me Klima (Inventore)	3,000.00 €	7,100.00 €	4,100.00 €
4	Furnizim me mjete te TI-se (kompjuter , switch ,disk etj)	8,000.00 €	9,500.00 €	1,500.00 €
5	Furnizim me pajisje për vëzhgim (kamera, DVR, HDD)	1,000.00 €	2,000.00 €	1,000.00 €
7	Furnizim me karrika dhe inventar te zyrës	3,000.00 €	3,000.00 €	0.00 €
8	Ndërtimi i Info Pullit ne Holl	0.00 €	6,900.00 €	6,900.00 €
9	Ndërtimi i fontanes	0.00 €	5,500.00 €	5,500.00 €
10	Furnizim me dyer te Hollit	0.00 €	11,200.00 €	11,200.00 €
11	Furnizim me LED Ekran 8.00m x 2.20m	0.00 €	18,000.00 €	18,000.00 €

Totali i kostove investive	16,200.00 €	64,400.00 €	48,200.00 €
----------------------------	-------------	-------------	-------------

Këto projekte do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e kënaqshmërisë së qytetarëve, rritjen e vlerës së markës së ndërmarrjes, dhe shtimin e të hyrave përmes besimit dhe përdorimit më të madh të shërbimeve.

7.4 Rritja e qëndrueshmërisë financiare

Rishikimi i planit të biznesit për vitin 2025 pasqyron një orientim të qartë drejt forcimit të qëndrueshmërisë financiare të ndërmarrjes, edhe përkundër rritjes së konsiderueshme të investimeve kapitale dhe shpenzimeve operative.

Të dhënat financiare tregojnë se të ardhurat neto pas amortizimit janë parashikuar të rriten nga 28,246.99 € në 215,171.89 €, që përfaqëson një rritje prej mbi 660%. Ky tregues konfirmon se ndërmarrja është orientuar drejtë një buxheti i cili do të grumbullojë fonde të cilat do të jenë të mjaftueshëm për të përballuar shpenzimet dhe që do ta ndihmojë ndërmarrjen në që të përpilojë një politik afatgjatë zhvillimore.

Te ardhurat NETO pas amortizimit (Te hyrat – Kostot)	28,246.99 €	215,171.89 €
--	-------------	--------------

8 Burimet njerëzore

Në kuadër të NPL "Stacioni i Autobusëve", SH. A. janë të punësuar 87 punëtor. Prej tyre janë 52 meshkuj dhe 35 femra. Mosha mesatare e punonjësve është 45.37 vjet.

Tabela e mëposhtme paraqet ngritjen profesionale të punëtorëve.

Kualifikimi	Totali
Master (sistemi një vjeçar dhe dy vjeçar)	17
Fakulteti (studime katër vjeçare)	3
Bachelor (studime themelore trevjeçare)	21
Shkollë e lartë	0
Shkollë e mesme	42
Punëtorë të kualifikuar (aftësim profesional)	3
Punëtorë të pakualifikuar (shkolla fillore)	1
Totali i punëtorëve	87

8.1 Nevojat aktuale për personel

Me qëllim të realizimit të objektivave të përcaktuara në këtë plan të biznesit, si dhe për qëllim të mbarëvajtjes së procesit të punës së NPL "Stacioni i Autobusëve", Sh.A. nevojitet të bëhen kushte e nevojshme për punë efektive.

Në bazë të lëvizjeve të brendshme të stafit gjatë pjesës së parë të vitit 2024 janë punësuar sipas nevojës për staf, pozita e Asistentes administrative të KE-së, Dispeçer të peronave, roje të natës, kurse në pjesën e dytë të vitit 2024 janë rekrutuarat staf me konkurs të jashtëm në pozitat kontabilist, likuidator, biletar dhe punëtor në sigurim.

Prioritet për vitin 2025 do të jete plotësimi i vendeve të punës për pozitat të cilat kanë mbet vakante si rrjedhojë e pensionimit me moshën si dhe pozitat e përcaktuara me rregullore për organizim të brendshëm dhe ato janë si në tabelën vijuese:

#	Pozita e punës	Numri i Ekzekutuesve
1	Koordinator i ndërrimit	1
2	Dispeçer i peronave	1
3	Nëpunës Gardërobë	1
4	Punëtorë në sigurim (Roje nate).	1
5	Mirëmbajtës i higjienës sanitare dhe i hapësirave të gjelbëruara	4
6	Teknik i teknologjisë informative	1
7	Asistent i zyrtarit Ligjor	1
8	Udhëheqës i Shërbimit Teknik	1
9	Arkëtar	3

NPL "Stacioni i Autobusëve", sh.a. vazhdon të operojë me strukturën organizative apo skemën funksionale e cila përputhet me strategjinë zhvillimore të Ndërmarrjes. Organogramin e Ndërmarrjes, si dhe pozitat e tjera sipas nevojës së Ndërmarrjes. Për më tepër organogrami i paraqitur në anëksin 5.

8.2 Politika e kompensimit të stafit dhe matja e performances

Në funksion të modernizimit të politikave të Burimeve Njerëzore dhe për të siguruar një sistem të drejtë e të motivueshëm të kompensimit, NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë ka miratuar një rregullore të re për kompensimin e stafit, e cila zëvendëson rregulloren ekzistuese nga viti 2016 që ishte ndryshuar shtatë herë gjatë periudhës së zbatimit

Rregullorja e re parasheh inkorporimin e rritjes së pagave të kalkuluar në fillim vit dhe në përputhje me planin fillestar të biznesit të vitit 2025 në normën prej 15% për të gjithë stafin dhe 10% për zyrtarët e lartë të ndërmarrjes, me qëllim motivimin dhe mbajtjen e kapaciteteve të kualifikuara brenda ndërmarrjes. Kjo rregullore synon gjithashtu nivelimin dhe standardizimin e pagave, duke u bazuar në kritere objektive dhe të matshme, siç janë:

- 8.2.1. Kualifikimi shkollor i kërkuar për vendin e punës;
- 8.2.2. Ndërlikueshmëria e punës, në raport me përgjegjësitë dhe sfidat që mbart pozita;
- 8.2.3. Rëndësia e detyrës në kuadër të funksionimit të përgjithshëm të ndërmarrjes;
- 8.2.4. Rrezikshmëria në vendin e punës, si faktor që ndikon në kompensimin shtesë;
- 8.2.5. Kushtet dhe intensiteti i punës, që lidhen me mjedisin dhe ngarkesën e punës;
- 8.2.6. Përvoja profesionale, e cila njihet si përparësi dhe vlerë e shtuar në sistemin e kompensimit.

Ky reformim i politikave të pagave pritet të përmirësojë performancën organizative, të rrisë motivimin dhe angazhimin e stafit, si dhe të kontribuojë në krijimin e një mjedisi më profesional dhe më efikas pune me një kosto prej € 10,054.25.

8.3 Ngritja e mirëqenës së punëtorëve

Bordi i Drejtorëve, përmes aprovimit të këtij Plani të Biznesit, ka miratuar edhe propozimin për mbulimin e sigurimit shëndetësor për të gjithë të punësuarit në NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë, në vlerë prej 28,500 €. Ky vendim pasqyron angazhimin e

ndërmarrjes për kujdes ndaj mirëqenies së stafit, duke e konsideruar atë një komponent të rëndësishëm për rritjen e motivimit dhe performancës së përgjithshme të punonjësve

.Anexi 5 struktura organizative (organogrami)

9 Plani operativ mbi zbërthimin e objektivave

Plani operativ për vitin 2025 nuk do të ketë ndryshime të mëdha në krahasim të vitit paraprak dhe është i bazuar në Objektivat dhe Strategjinë e ndërmarrjes dhe ka për qëllim që të njëjtat t'i zbërthej dhe t'i kthej objektivat në plan të veprimit.

Plani i veprimit gjithashtu do të trajtoj edhe objektivat jo financiare si ngritja profesionale dhe mirëqenien kolektive të stafit të ndërmarrjes. Te gjitha objektivat pritet të realizohen sipas planit.

9.1 Objektivat 1 Rritja e te hyrave optimizimit të burimeve ekzistuese

Rritja e të hyrave totale nga 1,212,517.26 € në 1,491,242.56 €, që përfaqëson një rritje prej rreth 23%, dëshmon për orientimin e ndërmarrjes drejt një modeli më efikas të menaxhimit financiar dhe operativ.

Ky objektiv do të realizohet përmes miratimit dhe zbatimit të çmimoreve të re të shërbimeve, e cila do të hyjë në fuqi më 01 korrik 2025. Çmimorja e re reflekton:

- a) Vlerësimin real të tregut,
- b) Kostot aktuale të operimit, si dhe
- c) Synimin për standardizim me praktikën e stacioneve tjera të kategorisë së njëjtë.

Ky vendim pritet të ndikojë drejtpërdrejt në:

- I. Rritjen e të ardhurave nga peronizimi,
- II. Përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve, dhe
- III. Krijimin e bazës së qëndrueshme për investime të ardhshme.

Edhe në periudhën e mbetur të vitit 2025, fokusi kryesor i menaxhmentit do të jetë bashkëpunimi me institucionet relevante të Komunës së Prishtinës dhe MMPHI-së që nisjet për qytetet e Mitrovicës e veçanërisht ato për qytetin e Podujevës të realizohen nga SAP.

Në periudhën vijuese menaxhmenti po të bejë përpjekje që të arrihet marrëveshje me Operatoret e Transportit Ndërkombëtar të fillohet shitja e biletave të udhëtimit për destinacionet ndërkombëtare që deri me tash shitja e biletave ka qene e mundeshme vetem per vendet fqinje ne regjion. Ky veprim do te ndikoj drejtpërdrejtë në shtimin e të hyrave financiare për ndërmarrjen.

9.2 Objektivi 2. Ngritja e cilësisë së shërbimeve .

Ky objektiv synon të përmirësojë përvojën e përdoruesve të shërbimeve dhe njëkohësisht të krijojë kushte më të mira të punës për stafin, përmes investimeve infrastrukturore dhe teknologjike të planifikuara për vitin 2025. Menaxhmenti tash me ka filluar kontakte e para me NPL Ndërmarrjen Publike Banesore sh.a dhe NPL Gjellbër sh.a, në mënyrë që objektivat e parashtruara në këtë plan biznes të arrihen shpejtë duke bashkpunuar edhe me ndërmarrjet si motra në Komunën e Prishtinës.

2.1. Masat konkrete për realizimin e këtij objektivi përfshijnë:

- Investime në infrastrukturë moderne, duke përfshirë:

- Lyerjen dhe renovimin e fasadës së ndërtesës,
- Rinovimin dhe modernizimin e sporteleve për ofrimin e shërbimeve,
- Instalimin e ndriçimit LED me qëllim të kursimit të energjisë dhe përmirësimit të ambientit të brendshëm.

2.2. Përmirësimi i kushteve të punës përmes:

Sigurimit të uniformave të reja për punëtorët,

- Investimeve në sisteme klimatike (klime) për rregullimin termik të ambienteve të punës dhe hapësirave të pritjes,
- Pajisjes me teknologji informative (TI) moderne që synon të rrisë efikasitetin dhe transparencën në menaxhimin e brendshëm dhe ofrimin e shërbimeve.

Përmes këtyre investimeve, SAP synon të krijojë një mjedis më funksional, më tërheqës dhe më profesional, duke rritur kënaqësinë e përdoruesve dhe moralin e stafit, si dhe duke kontribuar në modernizimin e përgjithshëm të ndërmarrjes

9.3 Objektivi 3. Zgjerimi i kapaciteteve operacionale dhe modernizimi

Me rishikimin e planit investiv për vitin 2025, SAP planifikon një rritje substanciale të investimeve kapitale, nga 16,200 € në 246,000 €, duke reflektuar një përkushtim të qartë për modernizim dhe zhvillim infrastrukturor.

Investimet e planifikuara përfshijnë projekte strategjike me ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e shërbimeve dhe përvojës së udhëtarëve, si dhe efikasitetin e operacioneve:

3.1. Ndërtimi i Info Point-it në hollin qendror

- Krijimi i një pikë informacioni moderne do të mundësojë orientim më të lehtë për udhëtarët, ofrim të informacionit në kohë reale dhe mbështetje për shërbimet e tjera digjitale.

3.2. Instalimi i ekranit LED informues (8m x 2.2m)

- Ky ekran do të përdoret për shpalljen e orarit të nisjeve, njoftime të rëndësishme për udhëtarët si dhe informacione të tjera komerciale apo institucionale, duke ngritur nivelin e informatizimit dhe komunikimit vizual brenda stacionit.

3.3. Renovim i toletit publik të ndërmarrjes

- Këto investime janë të domosdoshme në kuptimin e përmirësimit të shërbimeve që ofrohen në kuadër të ndërmarrjes

Këto investime janë të orientuara drejt rritjes së funksionalitetit, përmirësimit të përvojës së përdoruesve dhe forcimit të pozitës konkurruese të SAP në sektorin e transportit publik në Kosovë.

Buxheti 2025				
A.	1- Te hyrat	Plani momental	Rishikimi	Diferenca
#	Përshkrimi	Totali/Euro	Totali/Euro	Totali/Euro
1	Peronizimi	624,832.63 €	769,877.98 €	145,045.35 €
2	Shërbimi nga shitja e biletave	46,520.76 €	46,520.76 €	0.00 €
3	Komisioni nga shitja e biletave	12,505.93 €	12,505.93 €	0.00 €
4	Parkingu	343,532.55 €	443,914.87 €	100,382.32 €
5	Gardëroba	2,411.44 €	2,411.44 €	0.00 €
6	Qiratë nga lokalet	179,663.95 €	209,909.88 €	30,245.93 €
7	Te hyra nga marketingu	3,050.00 €	6,101.70 €	3,051.70 €
Totali i të hyrave		1,212,517.26 €	1,491,242.56 €	278,725.30 €
B	2- Kostot (Shpenzimet)	Plani momental	Rishikimi	Diferenca
#	2.1 Pagat dhe mëditjet	Totali/Euro	Totali/Euro	Totali/Euro
1	Bordi i drejtoreve (4 anetare te BD-se)	46,993.83 €	46,993.83 €	0.00 €
2	Zyrtaret e larte (KE, Sek, ZKFTH, ZAB)	50,485.12 €	50,485.12 €	0.00 €
3	Administrata	387,152.38 €	392,050.60 €	4,898.22 €
4	Operativa	534,108.58 €	539,264.61 €	5,156.03 €
5	Reprezentacion i KE-së	6,000.00 €	6,000.00 €	0.00 €
6	Shpërblime për puntoret e dalluar në operative	3,000.00 €	3,000.00 €	0.00 €
Totali i pagave		€ 1,027,739.91	€ 1,037,794.16	€ 10,054.25
C.	2.2. Kostot operative (mallra dhe shërbime)	Plani momental	Rishikimi	Diferenca
1	Energjia elektrike	16,523.45 €	16,523.45 €	0.00 €
2	Ujësjiellësi dhe kanalizimi	6,981.07 €	6,981.07 €	0.00 €
3	Grumbullimi i Mbeturinave	18,748.13 €	18,748.13 €	0.00 €
4	Mirëmbajtja e veturës servisim i rregullt	600.00 €	600.00 €	0.00 €
5	Furnizim me derivate për veture dhe gjenerator	2,000.00 €	2,000.00 €	0.00 €
6	Riparim i dyerve te hyrjes ne holl	2,500.00 €	2,500.00 €	0.00 €
7	Furnizim me material Higjienike Sanitare	1,805.00 €	1,805.00 €	0.00 €
8	Furnizimi me material administrativ, printim dhe dizajn	3,500.00 €	3,500.00 €	0.00 €
9	Furnizimi me ujë te pijes	1,001.00 €	1,001.00 €	0.00 €
10	Furnizim me uniforma për punëtore të ndërmarrjes	4,900.00 €	4,900.00 €	0.00 €
11	Furnizim me uniforma për punëtore te ndërmarrjes për dimër	0.00 €	4,900.00 €	4,900.00 €
12	Kalibrimi i arkave fiskale	361.02 €	361.02 €	0.00 €
13	Servisimi dhe kontrollimi i aparateve, mbikëqyrja e hidrateve rezistencës se tokëzimit dhe rrufepritisit	1,001.00 €	1,001.00 €	0.00 €
14	Shërbimi i dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim	950.00 €	950.00 €	0.00 €
15	Shërbimi i telefonisë mobile	1,326.98 €	1,326.98 €	0.00 €

16	Shërbimi i telefonisë fikse	982.35 €	982.35 €	0.00 €
17	Shërbim i internetit	1,050.00 €	1,050.00 €	0.00 €
18	Shërbim i internetit (beck up)	193.08 €	193.08 €	0.00 €
19	Shërbimi i digjitalizimit (laurat)	15,389.12 €	15,389.12 €	0.00 €
20	Furnizim me gypa për laura	500.00 €	0.00 €	-500.00 €
21	Shërbimi i printimit dhe fotokopjes	1,200.00 €	1,200.00 €	0.00 €
22	Domani i webit	276.00 €	276.00 €	0.00 €
23	Hostimi i emailave	310.08 €	310.08 €	0.00 €
24	Shërbimi për software për menaxhim të kontabilitet financiar	1,634.90 €	1,634.90 €	0.00 €
25	Shërbime të transportit me Taxi	419.89 €	419.89 €	0.00 €
26	Furnizim me mini traktor për kositjen e hapësirave me bari	4,500.00 €	4,500.00 €	0.00 €
27	Shërbimi i trajnimit të stafit për sigurim	350.00 €	350.00 €	0.00 €
28	Shpenzime operative të tjera (ad hoc)	2,050.00 €	2,050.00 €	0.00 €
29	Furnizim me materiale për renovimin dhe mirëmbajtjen e objektit	5,500.00 €	1,200.00 €	-4,300.00 €
30	Renovimi i fasadës - lysterja e objektit pjesa e jashtme	0.00 €	12,900.00 €	12,900.00 €
31	Lysterja e hollit pjesa e brendshme	0.00 €	2,500.00 €	2,500.00 €
32	Makin për kositjen e murit të gjallë	0.00 €	250.00 €	250.00 €
33	Trimer me penje për kositjen e barit	0.00 €	450.00 €	450.00 €
34	Kositëse e vogël për bari	0.00 €	350.00 €	350.00 €
35	Renovim i Sporteleve	0.00 €	5,000.00 €	5,000.00 €
36	Lysterjen e peronave	0.00 €	2,500.00 €	2,500.00 €
37	Lysterje dhe riparim i rrethojës së Ndërmarrjes	0.00 €	3,200.00 €	3,200.00 €
38	Shërbimi i printimit dhe fotokopjes, kontrata paraprake e shpenzuar	0.00 €	950.00 €	950.00 €
39	Mbjellja e drunjeve dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta	0.00 €	9,500.00 €	9,500.00 €
40	Eksursioni për punetoret	0.00 €	5,500.00 €	5,500.00 €
41	Organizimi i darkës së fundvitit për punetoret	0.00 €	3,200.00 €	3,200.00 €
42	Riparim i asfaltit të demtuar	0.00 €	9,900.00 €	9,900.00 €
43	Mjete të dedikuara për marketing	0.00 €	5,000.00 €	5,000.00 €
44	Renovim i toiletit publik të ndërmarrjes	0.00 €	20,000.00 €	20,000.00 €
Totali i kostove operative		96,553.07 €	177,853.07 €	81,300.00 €
D.	2.3 Kosto administrative	Plani momental	Rishikimi	Diferenca
1	Vlerësim për kënaqësinë e konsumatorit	1,050.00 €	1,050.00 €	0.00 €
2	Këshilltari dhe përfaqësues dhe përkthim	980.00 €	980.00 €	0.00 €
3	Auditimi i jashtëm	2,925.00 €	2,925.00 €	0.00 €
4	Detyrimet kontingjente (rastet gjyqësore)	5,603.85 €	2,950.00 €	-2,653.85 €
5	Pagat përcjellëse	2,000.00 €	2,000.00 €	0.00 €

6	Shpenzime administrative te tjera (ad hoc) Vlerësuesi i objektit , vlerësuesi , incizimi	9,900.00 €	9,900.00 €	0.00 €
7	Rivlerësim i pronave dhe asetëve te luajtshme	0.00 €	2,500.00 €	2,500.00 €
8	Angazhim të ekspertit për provizionim të borxheve	0.00 €	4,500.00 €	4,500.00 €
Totali i kostove administrative		22,458.85 €	26,805.00 €	4,346.15 €
E.	2.4 Investimet	Plani momental	Rishikimi	Diferenca
1	Furnizim me dritat e brendshme led për holla	1,200.00 €	1,200.00 €	0.00 €
3	Furnizim dhe montim me Klima (Inventore)	3,000.00 €	7,100.00 €	4,100.00 €
4	Furnizim me mjete te TI-se (kompjuter , switch ,disk etj)	8,000.00 €	9,500.00 €	1,500.00 €
5	Furnizim me pajisje për vëzhgim (kamera, DVR, HDD)	1,000.00 €	2,000.00 €	1,000.00 €
6	Furnizim me karrika dhe inventar te zyrës	3,000.00 €	3,000.00 €	0.00 €
7	Ndërtimi i Info Pullit ne Holl	0.00 €	6,900.00 €	6,900.00 €
8	Ndërtimi i fontanes	0.00 €	5,500.00 €	5,500.00 €
9	Furnizim me dyer te Hollit	0.00 €	11,200.00 €	11,200.00 €
10	Furnizim me LED Ekran 8.00m x 2.20m per marketing	0.00 €	18,000.00 €	18,000.00 €
11	Reklamen ndriqese me shkronja 3D	0.00 €	4,000.00 €	4,000.00 €
12	Furnizim me ndriçim te jashtem	0.00 €	12,000.00 €	12,000.00 €
Totali i kostove investive		16,200.00 €	80,400.00 €	64,200.00 €
F.	2.5 Amortizimi	Plani momental	Rishikimi	Diferenca
1	Ndërtesa	€		€
2	Pajisjet e zyrave	17,971.04	17,971.04	€
3	Automjetet	3,347.40	3,347.40	€
Totali i kostos se amortizimit		21,318.44 €	21,318.44 €	- €
		Plani momental	Rishikimi	Diferenca
1. Te hyrat totale (A)		1,212,517.26 €	1,491,242.56 €	278,725.30 €
2. Kostoja totale (B+C+D+E)		1,162,951.83 €	1,322,852.23 €	159,900.40 €
Te ardhurat Gross (Te hyrat - Kostot)		49,565.43 €	168,390.33 €	118,824.90 €
Amortizimi		21,318.44 €	21,318.44 €	0.00 €
Te ardhurat NETO pas amortizimit (Te hyrat - Kostot)		28,246.99 €	147,071.89 €	118,824.90 €

Kryesuesi i Bordit te Drejtoreve
NPL Stacioni i Autobuseve sh.p.k Prishtinë
Pallat DEMAJ
PRISTINA
PRISTINA
PRISTINA
07.2025

